



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 555/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Mamushë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), dega në Gjilan.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), në të cilën ankesë pretendohet se në Qendrën e Votimit 3201, vendvotimi nr. 1 në shkollën Zenel Hajdini në Mamushë, kryesuesi i vendvotimit z.Isak Kryeziu, ka bërë shkelje të ligjit për zgjedhje si dhe ligjeve tjera në fuqi duke lejuar futjen në votime për disa herë për anëtar dhe simpatizant të subjektit politik KDTP dhe nuk është përmbajtur sjelljeve që kërkohen nga një kryesues. Sipas parashtresës të ankesës në ora 10:00 e ka lejuar një qytetar që të voton dy deri në tri herë, po ashtu një qytetar tjetër e ka lejuar për të votuar për prindërit e tij që nuk kanë qenë prezent në vendvotim, kurse në orën 11:25 ka lejuar qytetar që nuk janë banor të Kosovës që të votojnë. Parashtresuesi i ankesës thekson se i njëjti në fund të procesit zgjedhor me rastin e mbylljes së kutive të votimit dhe procesverbaleve të njëjtin nuk e ka nënshkruar. Për këtë rast kanë qenë të njoftuar edhe përfaqësuesit ndërkombëtar që kanë qenë të pranishëm.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në Qendrën e Votimit në Mamushë nga kryesuesi i subjektit politik KDTP ka pasur parregullsi, PZAP-i i konsideron se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nga dëshmitë e ofruara nuk janë dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar kryesin e supozuar të shkeljes. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 555/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.